

Relacion viti 2016

Punoi

Artida AVDIA

Specialiste e Edukimit ne Vazhdim, UFSH

Relacion Edukimi në Vazhdim Janar – Dhjetor 2016

Urdhri i Farmacisteve të Shqipërisë, krahas detyrave të tjera ka për mision edhe ngritjen profesionale të farmacisteve. Nga UFSH kjo është realizuar nëpërmjet hartimit dhe planifikimit të programeve të kualifikimit të vazhdueshëm. Nga analiza që QKEV ka bërë, UFSH rezulton se është ofruesi kryesor për aktivitetet e edukimit në vazhdim për farmacistet në vend.

Për të përmbushur sa më mirë detyrimin tonë me profesionistët farmacistë kemi ofruar aktivitete nëpër të gjitha rajonet e Shqipërisë, bazuar edhe në numrin e farmacistëve dhe nevojat për kredite për secilin rajon.

Gjithashtu, jemi mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit që kemi me qendrën e “Telemedicinës” pranë QSUT e cila, na ka vendosur në dispozicion pa pagesë sallat e saj në Tiranë dhe në të gjitha rajonet e Shqipërisë, për zhvillimin e **Videokonferencave**. Videokonferencat janë një metodë mjaft efikase për të ulur në maksimum kostot për secilin aktivitet dhe për të shtuar numrin e krediteve të ofruara për secilin rajon. Duke shfrytëzuar këtë mundësi të ofruar nga Qendra e Telemjekësisë së Shqipërisë, seminarët këtë vit i kemi ofruar në të gjitha rajonet e Shqipërisë duke përfshirë dhe dy zona të skajshme siç është Saranda dhe Tropoja. Gjatë këtij viti janë ofruar 37 kredite për secilin rajon të Shqipërisë, aktivitete të cilat për rajonin e Tiranës, si rajoni me numrin më të madh të pjesëmarrësve, çdo aktivitet është përsëritur 2 herë. Ajo e cila vlen të theksohet ndryshe nga vitet e kaluara është fakti që këto seminare janë ofruar pa pagesë për farmacistet.

Në kuadër të Edukimit në Vazhdim, por edhe në funksion të rritjes së cilësisë së tij si dhe shtrirjes së bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë si brenda vendit dhe jashtë tij, UFSH ka qenë bashkëorganizatore me dy nga Universitetet private më në zë të Shqipërisë. Përkatësisht u organizuan dy Konferenca, ajo ndërkombëtare me Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe konferenca me “Albanian University”.

Në këto aktivitete morën pjesë, lektorët më në zë të universiteteve të Milanos, Napolit, Pizës e sigurisht të Shqipërisë. Konkretisht UFSH i mbështeti këto aktivitete në procedurat e akreditimit pranë Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim.

Vlen të theksohet edhe organizimi i Konferencës së IV ndërkombëtare të UFSH, e cila zgjati 2 dite dhe ofroi 10 kredite, me 34 pjesëmarrës aktiv ndërkombëtar dhe kombëtar nga profesionistët me ne ze të fushave perkatese. Me prezencën në këto konference pjesëmarrësit përveç krediteve përfituan edhe nga një dosje me material didaktikë cilësorë si dhe ftesën e hapur për darkën gala të organizuar me këto qëllim. UFSH këtë vit celebrroi edhe 10 vjetorin e formimit të tij, ku edhe shpërndau “Certifikatë mirënjohje” për farmacistët me ne ze të profesionit të farmacistit.

Problematikat e hasura nëpër aktivitetet e edukimit në vazhdim vihet re se janë të përsëritura ndër vite, dhe janë:

- Pjesëmarrje fiktive vecanerisht nëpër rajone
- Aktiviteti nuk zgjat sipas programit
- Mungesë e interesit

Sikurse është vepruar edhe këtë vit për disa aktivitete, janë bërë lista të diferencuara në varësi të orëve të qëndrimit, një mënyrë e përdorur për të mbajtur pjesëmarrësit present.

Gjithashtu është parashikuar që për vitin 2017, në mënyrë që të rritet efektiviteti i tyre planifikojmë që secili aktivitet të ofrojë deri në 3 kredite cka përkon me 2.5-3 ore aktivitet, si dhe për të shtuar interesin lidhur me temat që do të zhvillohen është parashikuar shpërndarja e tematikave të caktuara në muajt të caktuar (psh: muaji mars të jetë muaji i temave që i përkasin fushës së legjislacionit, muaji prill muaji i farmakologjisë, etj), kështu paraprakisht çdo farmacist të zgjedhi të ndjekë aktivitetet në interes të tij.

Thënë këto, UFSH për vitin 2017 planifikon që për 6 mujorin e parë të organizojë 7 aktivitete me nga 3 kredite dhe 2 tema secili. Pra, planifikojmë të sjellim 14 tema të reja të cilat për rajonin e Tiranës, bazuar edhe në numrin e pritshëm të pjesëmarrësve dhe në kapacitetin e sallës, do të përsëriten nga 2 here.

Nderkohe që për 6 mujorin e dytë planifikojmë të organizojmë një kurs online i cili do të ofrojë 3-5 kredite, dhe në muajin dhjetor planifikohen të organizohen 2-3 aktivitete të përsëritura për personat të cilët nuk të kenë pasur mundësi të përfitojnë minimumin e detyrueshëm vjetor deri në atë moment.

Në këto mënyra planifikojmë të ofrojmë deri në fund të vitit 2017, 25 kredite në të gjitha rajonet e Shqipërisë nga minimumi i detyrueshëm prej 5 kreditesh në vit dhe nga mesatarja prej 15 kreditesh për çdo vit.

Gjithashtu do të vazhdojnë bashkëpunimet si bashkëorganizator me UMT, Albanian University, etj

Bashkëlidhur pasqyra përmbledhëse e Edukimit në Vazhdim, për vitin 2016 si dhe një parashikim paraprak për vitin 2017.

Specialiste Edukimit Vazhdim

Artida Avdia